



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE**

PROJEKTVENDIM

Nr. _____, datë _____.2025

**PËR
MIRATIMIN E METODOLOGJISË, RREGULLAVE DHE PROCEDURAVE PËR
PËRCAKTIMIN E VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME
“NDËRTESA”, LLOGARITJEN E TAKSËS MBI NDËRTESEN DHE PAGESËN E
SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 21, pika 2, 22, pika 5, 22/1, 22/3 dhe 22/4 të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë, rregullave dhe procedurave për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, llogaritjen e taksës mbi ndërtesën dhe pagesën e saj, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Vendimi nr. 132, datë 7.3.2018, i Këshillit të Ministrave, “Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, e bazës së taksës për kategori specifike, natyrën dhe prioritetin e informacionit dhe të dhënave për përcaktimin e bazës së taksës, si dhe të kriterëve dhe rregullave për vlerësimin alternativ të detyrimit të taksës”, i ndryshuar, shfuqizohet me fillimin e efekteve të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Ministri i Shtetit për Pushtetin Vendor, Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i fillon efektet nga data 1 shkurt 2026.

KRYEMINISTËR

EDI RAMA

**METODOLOGJIA, RREGULLAT DHE PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E
VLERËS SË TAKSUESHME TË PASURISË SË PALUAJTSHME “NDËRTESE”,
LLOGARITJEN E TAKSËS MBI NDËRTESEN DHE PAGESËN E SAJ**

**KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1

Objekti

Metodologjia ka si objekt përcaktimin e:

- a. Rregullave dhe procedurave për përcaktimin e vlerës së taksueshme të njësisë së ndërtesës;
- b. Rregullave dhe procedurave për llogaritjen e taksës mbi ndërtesën;
- c. Rregullave, procedurave dhe afateve për pagesën e taksës mbi ndërtesën.

Neni 2

Përkufizime

Për qëllimin e zbatimit dhe interpretimit të kësaj metodologjie, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

1. “Banesë”, është çdo njësi ndërtese që përdoret/shfrytëzohet për nevoja themelore banimi si shtëpitë, apartamentet dhe njësitë e tjera të ngjashme.
2. “Çmim referues”, është vlere referuese për metër katror për njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim në një zonë vlere.
3. “Çmim për metër katror”, është vlere për metër katror e njësisë së ndërtesës që përcaktohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë metodologji.
4. “Dokument pronësie”, është çdo dokument ligjor i shkruar që përben titull pronësie, i cili i kalon ose i jep të drejtën e pronësisë mbi një njësi ndërtese të caktuar një personi të caktuar.
5. “Kategori ndërtese”, është kategoria që përfshin njësi ndërtesash, të klasifikuara dhe grupuara bashkë, për të përcaktuar shkallën e taksës që zbatohet. Kategoritë e ndërtesave janë 2 (dy). Ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim dhe ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
6. “Kategori vlere”, është kategoria e cila përfshin njësi ndërtesash, të klasifikuara dhe grupuara bashkë, në funksion të përcaktimit të vlerave të tyre të taksueshme. Kategoria e vlerës është nënndarje e kategorisë së ndërtesës.
7. “Ndërtesë” është një objekt që përfaqëson një strukturë ndërtimore, e cila mund të jetë një

njësi e vetme ndërtese ose të ketë dy ose më shumë të tilla, e ndërtuar mbi dhe/ose nën sipërfaqen e tokës dhe e lidhur në mënyrë të qëndrueshme dhe të vazhdueshme me tokën (trupëzuar me të) përmes themeleve ose elementeve mbajtëse të përhershme, dhe që plotëson kushtet e mëposhtme:

- a. ka minimalisht një kat, nënkat, gjysmëkat nën çati, ose krijon një volum/hapësirë ndërtimore të mbyllur ose gjysmë të mbyllur, të shfrytëzueshme për qëllime banimi ose veprimtari ekonomike;
- b. është e ngritur të paktën në strukturë nëse është e papërfunduar, ku struktura përbëhet nga elementet mbajtës vertikalë dhe horizontalë, përfshirë sistemin e lidhjes me tokën.

Për efekt të zbatimit të legjislacionit për taksën mbi ndërtesën, konsiderohen ndërtesa, pishinat e hapura të çdo lloji, si dhe strukturat dhe infrastruktura në funksion të mjediseve sportive të hapura, pishinave të hapura, parkimeve të hapura, porteve dhe aeroporteve, sipas përkufizimeve të dhëna në këtë metodologji. Nuk konsiderohen ndërtesa objektet e përkohshme, të ndërtuara me materiale të lehta e të çmontueshme, pa themele, pa struktura betonarmeje, blloqe betoni ose murature, të cilat mund të hiqen në çdo rast pa dëmtuar vetë objektin dhe terrenin ku janë vendosur dhe pa shpenzime të konsiderueshme ekonomike, si dhe çdo lloj strukture, stabilimenti ose impianti që shërben për ose përbën infrastrukturë lineare, si digat, kanalet e ujitjes dhe kullimit, rrjetet e kanalizimeve, shtyllat dhe linjat e energjisë, rrjetet e telekomunikacionit, gazsjellësit dhe naftësjellësit, tubacionet, hekurudhat, rrugët, urat, tunelet, mbi-kalimet, nën-kalimet dhe strukturat/impiantet e tjera të ngjashme.

8. “Ndërtesë e papërfunduar”, është një njësi ndërtese me leje ndërtimi, e cila nuk është përfunduar brenda afatit të përcaktuar në aktin e miratimit të kërkesës për leje ndërtimi.
9. “Ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim”, është kategoria e ndërtesës ku klasifikohet çdo njësi ndërtese e cila përdoret/shfrytëzohet për nevoja banimi, qoftë ky banim i përhershëm ose i përkohshëm. Në këtë kategori përfshihen banesat dhe njësi të tjera si, por pa u kufizuar te, bodrumet, garazhet, ose vendet e mbyllura të parkimit, që janë pasuri më vete, por nga ana funksionale, i shërbejnë plotësimin të nevojave të personave që jetojnë në banesa. Për efekt të zbatimit të legjislacionit në fuqi për taksën mbi ndërtesën, në këtë kategori përfshihet edhe çdo njësi ndërtese që është dhënë me qira afatgjatë për tu përdorur/shfrytëzuar për nevoja banimi.
10. “Ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”, është kategoria e ndërtesës ku klasifikohet çdo njësi ndërtese e cila përdoret/shfrytëzohet për veprimtari prodhuese, nxjerrëse, industriale, bujqësore, profesionale dhe tregtare, për ofrimin e mallrave dhe shërbimeve, ose për ndonjë veprimtari ekonomike tjetër. Për efekt të zbatimit të legjislacionit në fuqi për taksën mbi ndërtesën, në këtë kategori përfshihen edhe ndërtesat e banimit që përdoren/shfrytëzohen për të ofruar shërbime akomodimi për turistët, sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për turizmin.
11. “Njësi ndërtese”, është ndërtesa ose një pjesë e veçantë e një ndërtese, që është ligjërisht ose fizikisht e ndarë nga ndërtesa të tjera ose pjesë të ndërtesës që përdoret/shfrytëzohet për një qëllim të vetëm dhe zakonisht ka derën e saj hyrëse. Njësia e ndërtesës është objekt i taksës mbi ndërtesën.
12. “Përdorues”, është personi që ka në posedim njësinë e ndërtesës pa leje ose pa dokument

pronësie. Konsiderohet përdorues, për efekt të zbatimit të legjislacionit në fuqi për taksën mbi ndërtesën:

- a. Personi që ka në posedim një njësi ndërtese pa dokument pronësie, për të cilën ka lidhur një kontratë porosie, sipërmarrjeje, premtim shitjeje ose kontratë tjetër me qëllim fitimin e pronësisë mbi njësinë në të ardhmen;
 - b. Personi që ka në posedim një njësi ndërtese pa leje ose pa dokument pronësie dhe ka aplikuar për legalizimin ose pajisjen me dokument pronësie të njësisë së tij të ndërtesës, por ende nuk e ka marrë atë; si dhe
 - c. Personi që ka në posedim një njësi ndërtese pa leje ose pa dokument pronësie por nuk ka aplikuar për legalizimin ose marrjen e dokumentit të pronësisë për të.
13. "Pronar", është personi që është titullari i dokumentit të pronësisë për një njësi ndërtese të caktuar.
 14. "Përdorim/shfrytëzim faktik", është mënyra se si një njësi ndërtese përdoret/shfrytëzohet në të vërtetë (përdorimi/shfrytëzimi de-fakto i saj).
 15. "Person", është individ, personi fizik ose personi juridik.
 16. "Sistem informatik i regjistrimit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale)", është *software* ose grupi i programeve kompjuterike që iu mundëson përdoruesve të autorizuar të përdorin funksionalitete të ndryshme, për të regjistruar, përditësuar, korrigjuar ose përpunuar në forma të tjera dhe në përputhje me autorizimet ligjore të dhënat në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale).
 17. "Vlerë e taksueshme", është vlera e njësisë së ndërtesës që përcaktohet në përputhje me rregullat e parashikuara në këtë metodologji dhe shërben si bazë për aplikimin e shkallës së taksës mbi ndërtesën.
 18. "Zonë vlere", është një zonë e caktuar gjeografike brenda territorit administrativ të njësisë së vetëqeverisjes vendore (në vijim bashkia), që ka një çmim referues në aneksin nr.1 që i bashkëlidhet kësaj metodologjie dhe është pjesë përbërëse e saj. Zona e vlerës mund të jetë një qytet, zonë e qytetit, njësi administrative jashtë qytetit ose çdo zonë tjetër gjeografike e përcaktuar në aneksin nr.1 që i bashkëlidhet kësaj metodologjie dhe është pjesë përbërëse e saj..
 19. "Zhvillues", është personi në emër të të cilit është lëshuar leja e ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
 20. "Sipërfaqja e brendshme (neto)", është sipërfaqja e hapësirave të brendshme të njësisë së ndërtesës, e matur nga faqja e brendshme e mureve perimetrale, duke përfshirë muret ndarëse të brendshme, shtyllat dhe elementet strukturore brenda njësisë, si dhe të gjitha hapësirat e përdorshme (p.sh. dhoma, korridore, kuzhina, tualete, ballkone dhe veranda).
 21. "Struktura/infrastruktura në funksion të mjediseve sportive të hapura" është tërësia e zyrave

të administratës, dhomave të zhveshjes, objekteve, impianteve, sistemeve dhe çdo infrastrukturë tjetër ndihmëse që shërben drejtpërdrejt për funksionimin e mjediseve sportive të hapura, përfshirë por pa u kufizuar te, fushat e futbollit, minifutbollit, basketbollit, volejbollit, tenisit, golfit, si dhe pistat për gara atletike, motorike, me kuaj ose veprimtari të tjera sportive të ngjashme. Në këtë kategori nuk përfshihen njësitë e ndërtesave brenda këtyre komplekseve që përdoren për qëllime të tjera të pavarura ose të palidhura drejtpërdrejt me funksionimin e mjediseve sportive të hapura, si aktivitete tregtare, shitje me pakicë, ofrim shërbimesh etj.

22. “Struktura/infrastruktura në funksion të pishinave dhe parkimeve të hapura, porteve dhe aeroporteve” është tërësia e zyrave të administratës, ambienteve për përdoruesit/pasagjeret, objekteve, impianteve, sistemeve dhe çdo strukture ose infrastrukturë tjetër ndihmëse që shërben drejtpërdrejt për funksionimin e pishinave dhe parkimeve të hapura, si dhe të porteve dhe aeroporteve të çdo kategorie. Në këtë kategori nuk përfshihen njësitë e ndërtesave brenda këtyre komplekseve që shfrytëzohen për qëllime të tjera të pavarura ose të palidhura drejtpërdrejt me funksionimin e parkimit, portit ose aeroportit, si aktivitete tregtare, shitje me pakicë, ofrim shërbimesh etj.

Neni 3 **Kategoritë e vlerave**

1. Kategoritë e vlerave të ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim janë si më poshtë vijon:
 - a. Shtëpi;
 - b. Apartament;
 - c. Garazh ose vend parkimi brenda ndërtesës;
 - ç. Bodrum;
 - d. Njësi tjetër ndërtese që përdoret/shfrytëzohet për banim dhe nuk i përket asnjë prej kategorive të vlerave të përcaktuara në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç”, të kësaj pike.
2. Kategoritë e vlerave të ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike, përcaktohen në aneksin nr. 2 që i bashkëlidhet dhe është pjesë përbërëse e kësaj metodologjie.

KREU II
RREGULLAT, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR PËRCAKTIMIN E
VLERËS SË TAKSUESHME TË NJËSISË SË NDËRTESES DHE LLOGARITJEN
E TAKSËS MBI NDËRTESEN

Neni 4

Përcaktimi i sipërfaqes dhe vendndodhjes së njësisë së ndërtesës në funksion të llogaritjes së vlerës së saj të taksueshme dhe taksës për të

1. Bashkia është përgjegjëse për përcaktimin e sipërfaqes dhe vendndodhjes së njësisë së ndërtesës në funksion të llogaritjes së vlerës së saj të taksueshme dhe taksës për të.
2. Të dhënat mbi sipërfaqen dhe vendndodhjen e njësisë së ndërtesës, përcaktohen duke u bazuar në një ose disa nga burimet e mëposhtme:
 - a. Informacioni i marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
 - b. Informacioni i marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - c. Informacioni i mbledhur nga bashkia gjatë evidentimit në terren të njësive të ndërtesave;
 - ç. Informacioni i mbledhur përmes vetë deklarimeve të paraqitura nga pronarët, zhvilluesit dhe përdoruesit e njësive të ndërtesave, për zbatimin e legjislacionit për taksën mbi ndërtesën;
 - d. Informacioni i marrë nga agjenti i caktuar për mbledhjen e taksës;
 - dh. Certifikatat e pronësisë, kartelat e pasurisë, dokumentet e pronësisë, të transferimit në administrim ose në përdorim të njësive të ndërtesave që disponohen nga bashkitë;
 - e. Lejet e ndërtimit të miratuar nga bashkia përkatëse ose Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.
3. Nëse për sipërfaqen e njësisë së ndërtesës bashkia disponon të dhëna nga burime të ndryshme që nuk përputhen, bashkia e përcakton sipërfaqen e njësisë së ndërtesës duke e bazuar në të dhënat, sipas radhës së mëposhtme të përparësisë:
 - a. Sipërfaqja e konstatuar e njësisë së ndërtesës gjatë evidentimit që është kryer në terren nga bashkia ose Agjencia Shtetërore e Kadastrës, duke u bazuar në rezultatet e evidentimit në terren që ka ndodhur më vonë në kohë;
 - b. Sipërfaqja e njësisë së ndërtesës sipas informacionit të marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;

- c. Sipërfaqja e njësisë së ndërtesës sipas certifikatës së pronësisë, kartelës së pasurisë, dokumentit të pronësisë, dokumentit të transferimit në administrim ose dokumentit të transferimit në përdorim të asaj njësie ndërtese, që disponohet nga bashkia;
 - ç. Sipërfaqja e njësisë së ndërtesës sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga bashkia përkatëse ose Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;
 - d. Sipërfaqja e njësisë së ndërtesës sipas të dhënave të vetë deklaruara nga pronari, zhvilluesi ose përdoruesi i saj për zbatimin e legjislacionit për taksën mbi ndërtesën.
4. Nëse sipërfaqja e njësisë së ndërtesës, bazuar në informacionin e mbledhur gjatë evidentimit në terren nga bashkia, sipas shkronjës “c”, të pikës 2, të këtij neni, rezulton të jetë më e vogël se ajo e siguruar nga burimet e përcaktuara në shkronjat “a”, “dh” dhe “e”, të së njëjtës pikë, atëherë ajo nuk merret parasysh për përcaktimin e sipërfaqes, sipas radhës së përparësisë.
 5. Nëse për vendndodhjen e njësisë së ndërtesës bashkia disponon të dhëna nga burime të ndryshme që nuk përputhen, bashkia e përcakton vendndodhjen e njësisë së ndërtesës duke u bazuar në të dhënat, sipas radhës së mëposhtme të përparësisë:
 - a. Vendndodhja e konstatuar e njësisë së ndërtesës gjatë evidentimit që është kryer në terren nga bashkia ose Agjencia Shtetërore e Kadastrës, duke u bazuar te rezultatet e evidentimit në terren që ka ndodhur më vonë në kohë;
 - b. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile;
 - c. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas informacionit të marrë nga agjenti i caktuar për mbledhjen e taksës;
 - ç. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas informacionit të marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës;
 - d. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas certifikatës së pronësisë, kartelës së pasurisë, dokumentit të pronësisë, dokumentit të transferimit në administrim ose dokumentit të transferimit në përdorim të asaj njësie ndërtese, që disponohet nga bashkia;
 - dh. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas lejes së ndërtimit të miratuar nga bashkia përkatëse ose Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit;
 - e. Vendndodhja e njësisë së ndërtesës sipas të dhënave të vetë deklaruara nga pronari, zhvilluesi ose përdoruesi i saj për zbatimin e legjislacionit për taksën mbi ndërtesën.
 6. Në rastet kur identifikohet ekzistenca e njësisë së ndërtesës, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja dhe vendndodhja e saj, zbatohen parashikimet e nenit 16, të kësaj metodologjie.

Neni 5

Rregullat për klasifikimin e njësisë së ndërtesës

1. Bashkia kryen klasifikimin e njësive të ndërtesave që ndodhen në territorin e saj, duke u bazuar në rregullat e parashikuara në këtë nen.
2. Për qëllimet e zbatimit të kësaj metodologjie, njësia e ndërtesës klasifikohet vetëm në një kategori të caktuar vlere dhe një kategori të caktuar ndërtesë.
3. Klasifikimi i njësisë së ndërtesës në një kategori të caktuar vlere dhe ndërtesë bazohet në përdorimin/shfrytëzimin faktik të saj, sipas informacionit të mbledhur gjatë evidentimit që është kryer në terren ose verifikimeve të tjera të kryera nga njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse.
4. Nëse përdorimi/shfrytëzimi faktik nuk disponohet ose nuk arrihet të përcaktohet nga bashkia, njësia e ndërtesës klasifikohet duke u bazuar në përdorimin/shfrytëzimin e njësisë së ndërtesës, sipas informacionit të marrë nga agjenti i caktuar për mbledhjen e taksës.
5. Nëse të dhënat sipas pikave 3 dhe 4, të këtij neni nuk disponohen ose janë të tilla që nuk mund të përdoren për të bërë klasifikimin e njësisë së ndërtesës në një kategori të caktuar ndërtesë dhe/ose vlere, njësia klasifikohet duke u bazuar në të dhënat mbi llojin e pasurisë, sipas informacionit të marrë nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës.
6. Nëse të dhënat sipas pikës 5 nuk disponohen ose janë të tilla që nuk mund të përdoren për të bërë klasifikimin e njësisë së ndërtesës në një kategori të caktuar ndërtesë dhe/ose vlere, njësia ndërtesës klasifikohet duke u bazuar në të dhënat mbi llojin e pasurisë, në dokumentin e pronësisë ose dokumentin e transferimit në administrim ose përdorim të asaj njësie ndërtesë dhe nëse as këto të fundit nuk disponohen, duke u bazuar në përdorimin/shfrytëzimin e destinuar të njësisë së ndërtesës, sipas lejes së ndërtimit.
7. Nëse të dhënat sipas pikave 3, 4, 5 dhe 6 të këtij neni nuk disponohen ose janë të tilla që nuk mund të përdoren për të bërë klasifikimin e njësisë së ndërtesës në një kategori të caktuar ndërtesë dhe/ose vlere, njësia klasifikohet duke u bazuar në informacionin e vetëdeklaruar nga përdoruesi, zhvilluesi ose pronari i ndërtesës për zbatimin e legjislacionit për taksën mbi ndërtesën.
8. Nëse nga evidentimi në terren ose verifikimet konstatohet se njësia e ndërtesës përdoret/shfrytëzohet për dy ose më shumë qëllime, të cilat plotësojnë kriteret për t'u konsideruar njësi më vete, sipas kuptimit të dhënë në pikën 11 të nenit 2 të kësaj metodologjie, atëherë ajo ndahet në dy ose më shumë njësi të reja.
9. Në rastet kur identifikohet ekzistenca e njësisë së ndërtesës, por nuk arrihet të përcaktohet kategoria e saj e ndërtesës dhe/ose e vlerës, zbatohen parashikimet e nenit 16 të kësaj metodologjie.

Neni 6

Vetë deklarimi

1. Çdo pronar, përdorues ose zhvillues i një njësie ndërtese mund të vetë deklarojë të dhënat për njësinë e ndërtesës që ka në pronësi, në posedim, ose që po zhvillon. Vetëdeklarimi shoqërohet së bashku me dokumentacionin mbështetës përmes të cilit pronari, përdoruesi ose zhvilluesi i njësisë së ndërtesës vërteton të dhënat e vetë deklaruara. Vetëdeklarimet që paraqiten pa dokumentacionin mbështetës provues nuk pranohen.
2. Vetëdeklarimi bëhet personalisht pranë bashkisë ku ndodhet njësia e ndërtesës ose përmes shërbimit të deklarimit elektronik (e-deklarimi). Çdo pronar, përdorues ose zhvillues i një njësie ndërtese mund të vetëdeklarojë të dhënat për njësinë e ndërtesës, deri më 31 tetor të vitit para vitit tatimor.
3. Bashkia ka detyrimin të verifikojë të dhënat e vetëdeklaruara. Verifikimi bëhet edhe përmes evidentimit në terren në raste të caktuara, nëse ky i fundit vlerësohet të jetë i nevojshëm.
4. Kur nga verifikimi konstatohen mospërputhje midis të dhënave të vetëdeklaruara dhe dokumentacionit mbështetës, bashkia bazohet tek të dhënat e dokumentacionit mbështetës nëse mospërputhja përbën një gabim material të dukshëm ose pasaktësi të qartë. Në çdo rast tjetër, bashkia njofton deklaruesin për mospërputhjen dhe i kërkon paraqitjen e një vetëdeklarimi të ri.
5. Modeli i formularit tip të vetëdeklarimit dhe dokumentet që duhet të paraqiten për të vërtetuar të dhënat e vetëdeklarimit miratohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë pas konsultimit me bashkitë.

Neni 7

Evidentimi në terren i njësive të ndërtesave

1. Bashkia ka të drejtë të evidentojë në terren ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave që ndodhen brenda territorit të bashkisë.
2. Evidentimi në terren shërben kryesisht për të regjistruar ndërtesa dhe njësi ndërtesash të reja që nuk janë regjistruar në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), por edhe për të verifikuar dhe nëse është e nevojshme korrigjimit, plotësuar ose përditësuar të dhënat mbi ndërtesat dhe njësitë e ndërtesave që janë të regjistruara te kjo e fundit.
3. Evidentimi në terren bëhet në një mënyrë të arsyeshme, që minimizon shqetësimet ose ndërhyrjet ndaj personit i cili ka në pronësi, zhvillon ose përdor njësinë e ndërtesës.
4. Të gjithë pronarët dhe/ose përdoruesit e njësive të ndërtesave, që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike, si dhe zhvilluesit e njësive të ndërtesave pavarësisht kategorisë së tyre, janë të detyruar t'i lejojnë personat e autorizuar që përfaqësojnë bashkinë, të hyjnë

në njësitë e tyre të ndërtesave, për të mbledhur informacionin e nevojshëm për to. Hyrja në njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim mund të realizohet vetëm pas autorizimit të shprehur të pronarit ose përdoruesit të njësisë së ndërtesës.

5. Matja e sipërfaqes së një njësie ndërtese, gjatë evidentimit në terren, bëhet nga jashtë njësisë së ndërtesës. Në rastet kur matja e sipërfaqes nuk mund të kryhet nga jashtë, ajo realizohet nga brenda njësisë së ndërtesës, duke përcaktuar sipërfaqen e brendshme (neto) të saj.
6. Në rast se personi që ka në pronësi, zhvillon ose përdor njësinë e ndërtesës, nuk ndodhet në mjediset e saj, në ditën e evidentimit në terren, përfaqësuesi i bashkisë vendos një njoftim në derën hyrëse ose në një vend tjetër të dukshëm të njësisë së ndërtesës. Njoftimi përmban ditën dhe orën kur do të bëhet një tentative e dytë, si dhe një paralajmërim, mbi parashikimet ligjore të pikës 7, të këtij neni.
7. Në rast se pronari, zhvilluesi ose përdoruesi i njësisë së ndërtesës, nuk gjendet në ambientet e saj edhe gjatë tentativës së dytë, ose pengon përfaqësuesin e bashkisë që të kryejë evidentimin në terren, dhe nuk disponohet informacion tjetër për njësinë e ndërtesës, vlera e taksueshme për atë njësi ndërtese përcaktohet sipas parashikimeve në nenin 16, të kësaj metodologjie. Në këto raste, përfaqësuesi i bashkisë dokumenton mungesën ose pengimin përmes një procesverballi dhe kur është e mundur e vërteton situatën me nënshkrimin e një dëshmitari të pranishëm. Një kopje e procesverballit i dërgohet ose dorëzohet pronarit, zhvilluesit ose përdoruesit të njësisë së ndërtesës, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e evidentimit në terren.
8. Përfaqësuesi i bashkisë plotëson formularin e evidentimit në terren, duke shënuar datën e evidentimit në terren dhe plotësuar gjithë rubrikat e tjera të detyrueshme të formularit.
9. Përfaqësuesi i bashkisë informon pronarin, zhvilluesin ose përdoruesin e njësisë së ndërtesës mbi të dhënat e shënuara gjatë evidentimit në terren. Pronari, zhvilluesi ose përdoruesi ka te drejtë të bëjë komentet e tij, nëse dëshiron, në lidhje me përmbajtjen e formularit të evidentimit në terren. Një kopje e formularit të evidentimit në terren i dërgohet ose dorëzohet pronarit, zhvilluesit ose përdoruesit të njësisë së ndërtesës, brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita e evidentimit në terren.
10. Modeli i formularit tip të evidentimit në terren miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, pas konsultimit me bashkitë.

Neni 8

Verifikimi i të dhënave nga ana e nëpunësit përgjegjës në bashki për taksën mbi ndërtesën

1. Nëpunësi përgjegjës, për taksën mbi ndërtesën në bashki, ka detyrimin të bëjë verifikimin e formularit dhe dokumentacionit të mbledhur gjatë procesit të evidentimit në terren.
2. Nëse formulari i evidentimit në terren përmban gabime, mangësi ose pasaktësi, nëpunësi

përgjegjës kërkon nga përfaqësuesit e bashkisë që e kanë plotësuar atë, ta rishikojnë dhe nëse është e nevojshme, ta përsërisin procedurën e evidentimit në terren.

3. Pas kryerjes së verifikimit, nëpunësi përgjegjës konfirmon nga ana formale saktësinë e të dhënave dhe autorizon regjistrimin e tyre në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale).
4. Të dhënat e mbledhura gjatë evidentimit në terren regjistrohen në regjistrin qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), brenda 7 (shtatë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së konfirmimit të nëpunësit përgjegjës që ka kryer verifikimin sipas këtij neni.

Neni 9 **Çmimi referues**

1. Çmimet referuese për zonat e vlerave brenda territorit të bashkive, përcaktohen në aneksin nr.1 që i bashkëlidhet kësaj metodologjie dhe është pjesë përbërëse e saj.
2. Çmimi referues i zonës së vlerës përdoret për të përcaktuar çmimin për metër katror të njësive të ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për banim dhe për veprimtari ekonomike brenda asaj zone vlere.

Neni 10 **Çmimi për metër katror**

1. Çmimi për metër katror, për njësinë e ndërtesës që përdoret/shfrytëzohet për banim, është i barabartë me çmimin referues në zonën e vlerës ku ndodhet njësia e ndërtesës që i nënshtrohet taksimit.
2. Si përjashtim ndaj pikës 1, të këtij neni, për banesat e privatizuara në zbatim të legjislacionit për privatizimin e banesave shtetërore, çmimi për metër katror është 70% (shtatëdhjetë për qind) e çmimit referues në zonën e vlerës ku ndodhet banesa që i nënshtrohet taksimit.
3. Për njësitë e ndërtesave që përdoren/shfrytëzohen për veprimtari ekonomike, zbatohen çmimet për metër katror, të përcaktuara në aneksin nr. 2 që i bashkëlidhet kësaj metodologjie dhe është pjesë përbërëse e saj.

Neni 11 **Vlera e taksueshme**

1. Bashkia ka detyrimin e përcaktimit të vlerës së taksueshme për çdo njësi ndërtese që i nënshtrohet taksimit në territorin e saj. Vlera e taksueshme e njësisë së përfunduar të ndërtesës llogaritet si shumëzim i çmimit për metër katror të njësisë së ndërtesës me

sipërfaqen e saj.

2. Vlera e taksueshme e strukturave dhe infrastrukturës në funksion të mjediseve sportive të hapura, pishinave të hapura, parkimeve të hapura, porteve dhe aeroporteve përcaktohet duke shumëzuar çmimin për metër katror me:
 - a. sipërfaqen e strukturave ndërtimore të mbyllura ose gjysmë të mbyllura në këto komplekse; dhe
 - b. sipërfaqen ku shtrihen ose zënë mjediset e hapura dhe strukturat ndërtimore të hapura që u përkasin këtyre komplekseve.
3. Përcaktimi i vlerës së taksueshme të ndërtesës së papërfunduar, bazohet në koston e parashikuar të ndërtimit, në lejen e ndërtimit të miratuar nga bashkia përkatëse ose Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit.
4. Vlera e taksueshme e ndërtesës së papërfunduar është e barabartë me koston e parashikuar për ndërtimin e gjithë ndërtesës, kur është një njësi e vetme dhe e destinuar për një qëllim të vetëm përdorimi/shfrytëzimi.
5. Në rast se ndërtesa e papërfunduar përbëhet nga më shumë se një njësi ndërtimesi, të parashikuara për t'u shfrytëzuar për qëllime të ndryshme ose për t'u tjetërsuar si njësi të veçanta, si vlerë e taksueshme e secilës njësi do të shërbejë kosto e parashikuar për ndërtimin e njësisë.
6. Nëse kosto e parashikuara për ndërtimin e njësisë së ndërtesës nuk disponohet, ajo do të përcaktohet duke shumëzuar sipërfaqen e njësisë përkatëse me koston e ndërtimit për metër katror. Kosto e ndërtimit për metër katror llogaritet duke pjesëtuar koston e parashikuar për ndërtimin e të gjithë ndërtesës me sipërfaqen e përgjithshme të saj, bazuar në të dhënat e lejes së ndërtimit.
7. Në ato raste kur ndërtesa ose njësi të veçanta të saj janë vënë në përdorim, pavarësisht se ndërtesa në tërësi nuk ka përfunduar, taksa llogaritet duke aplikuar shkallën e plotë të taksës për njësitë e ndërtesës që përdoren. Në këtë rast, vlera e taksueshme përcaktohet duke u bazuar në koston e ndërtimit për pjesën e papërfunduar dhe në përputhje me pikën 1, të këtij neni, për njësitë e vëna në përdorim.
8. Në të gjitha rastet e përmendura në këtë nen, personi që ka detyrimin të paguajë taksën e ndërtesës është zhvilluesi, me përjashtim të rastit kur njësi të ndërtesës të vëna në përdorim, janë transferuar në posedim ose pronësi të personave të tjerë. Për këto të fundit, detyrimin për pagimin e taksës mbi ndërtesën e ka përdoruesi ose pronari.

Neni 12

Dëmtimet për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.)

Në rastet kur konstatohen dëmtime të njësisë së ndërtesës për shkaqe të fatkeqësive natyrore (tërmet/zjarr/përmbytje etj.), bashkia ngre një komision brenda 14 (katërmëdhjetë) ditëve kalendarike nga dita kur ka ndodhur fatkeqësia natyrore. Komisioni vlerëson dëmin e shkaktuar

dhe i paraqet këshillit bashkiak një raport, me qëllim lehtësimin e përkohshëm të taksapaguesit nga taksa e ndërtesës, në zbatim të nenit 21, të ligjit për sistemin e taksave vendore. Vlerësimi bëhet sipas gjendjes fizike në të cilën paraqitet njësia e dëmtuar e ndërtesës dhe bazohet, nëse ka, në akt ekspertizat e kryera nga institucionet kompetente. Nëse njësia e ndërtesës ka pësuar dëme të mëdha dhe si rrjedhim është planifikuar për tu prishur, sipas një vendimi zyrtar të institucioneve kompetente, i vendoset shënimi “planifikuar për tu prishur” dhe vlera e saj e taksueshme zerohet.

Neni 13

Shkallët e taksës

1. Këshilli Bashkiak mund të miratojë shkallë të taksës brenda kufijve +30% (plus tridhjetë për qind) -30% (minus tridhjetë për qind), të shkallëve përkatëse të taksës të përcaktuara në ligjin për sistemin e taksave vendore për 2 (dy) kategoritë e ndërtesave, në të gjithë territorin e bashkisë.
2. Këshilli Bashkiak i çdo bashkie miraton shkallët e taksës, jo më vonë se data 20 shkurt e vitit tatimor.
3. Nëse Këshilli Bashkiak nuk miraton shkallët e taksës, brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, zbatohen shkallët përkatëse të taksës të përcaktuara në ligjin për sistemin e taksave vendore.
4. Shkallët e miratuara të taksës i dërgohen Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga dita e miratimit të tyre.

Neni 14

Llogaritja e taksës mbi ndërtesën dhe njoftimi i saj

1. Bashkia ka detyrimin e llogaritjes së taksës për çdo njësi ndërtese që i nënshtrohet taksimit në territorin e saj.
2. Taksa mbi ndërtesën llogaritet si detyrim vjetor i taksapaguesit, ditën e fundit të shkurtit, në çdo vit tatimor.
3. Taksa mbi ndërtesën llogaritet si shumëzim i vlerës së taksueshme të njësisë së ndërtesës me shkallën e zbatueshme të taksës dhe i njoftohet taksapaguesit përmes njoftimit të vlerësimit të taksës mbi ndërtesën ose faturës së agjentit të caktuar për mbledhjen e saj.
4. Bashkia gjeneron njoftimet e vlerësimit të taksës mbi ndërtesën, për të gjithë ata taksapagues që nuk njoftohen për detyrimet e tyre përmes agjentit të caktuar për mbledhjen e taksës. Njoftimet e vlerësimit të taksës mbi ndërtesën gjenerohen përmes sistemit informatik të regjistrit qendror të bazës së të dhënave të pasurive të paluajtshme (Kadastra Fiskale), jo më vonë se data 7 (shtatë) mars e vitit tatimor.
5. Modeli tip i njoftimit të vlerësimit të taksës mbi ndërtesën, miratohet nga Drejtoria e

Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, duke mbajtur parasysh kërkesat e nenit 69 të ligjit për procedurat tatimore, pas konsultimit me bashkitë.

Neni 15

Lindja e detyrimit për taksën e ndërtesës pas llogaritjes së taksës

Ndryshimi i përdorimit/shfrytëzimit të njësisë së ndërtesës, rritja ose zvogëlimi i sipërfaqes ose ndonjë ndryshim tjetër i karakteristikave të njësisë së ndërtesës, që sjell për pasojë ndryshimin e vlerës së taksueshme të saj, pas llogaritjes së taksës për një vit të caktuar tatimor, merret/merren parasysh kur llogaritet vlera e taksueshme dhe taksa e ndërtesës në vitin pasues tatimor.

Neni 16

Rregullat për prezumimin e faktorëve të nevojshëm për përcaktimin e vlerës së taksueshme dhe shkallës së taksës në funksion të llogaritjes së taksës mbi ndërtesën (vlerësimi alternativ i detyrimit të taksës)

1. Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet sipërfaqja e njësisë së ndërtesës që përdoret/shfrytëzohet për banim ose për veprimtari ekonomike, përdoret në vitin e parë të hyrjes në fuqi të kësaj metodologjie, vlera e prezumuar si më poshtë:
 - a. 20 (njëzetë) metra katror për garazhet dhe vendet e mbyllura të parkimit në kategorinë “ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim”;
 - b. 70 (shtatëdhjetë) metra katror për banesat që janë privatizuar në zbatim të legjislacionit për privatizimin e banesave shtetërore dhe bodrumet në kategorinë “ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim”;
 - c. 100 (njëqind) metra katror për të gjithë njësitë e tjera të ndërtesave që përfshihen në kategorinë “ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim”; dhe
 - ç. 200 (dyqind) metra katror për të gjithë njësitë e ndërtesave në kategorinë “ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike.
2. Nëse nga evidentimet në terren ose nga burime të tjera të dhënash vërtetohet se njësia e ndërtesës përbëhet nga më shumë se një kat, sipërfaqja e prezumuar, sipas përcaktimeve në shkronjat “a”, “b”, “c” dhe “ç” të pikës 1 të këtij neni, zbatohet për secilin kat të saj.
3. Bashkia është e detyruar të sigurojë informacionin mbi sipërfaqet, në vitin pasues tatimor, për të gjitha njësitë e ndërtesave në kategorinë “ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike”, për të cilat është përdorur sipërfaqja e prezumuar në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, përfshirë këtu, nëse është e nevojshme, evidentimin në terren të sipërfaqeve të këtyre njësive.
4. Sipërfaqja e prezumuar e përcaktuar në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, rritet me 10 % (dhjetë përqind), në çdo vit pasues tatimor, deri në momentin e përcaktimit të sipërfaqes së

njesisë së ndërtesës, nëpërmjet vetëdeklarimit të taksapaguesit ose ndonjë mënyrë tjetër për sigurimin e informacionit mbi sipërfaqen, të parashikuar në legjislacionin në fuqi.

5. Nëse identifikohet ekzistenca dhe bashkia ku ndodhet, por nuk arrihet të përcaktohet vendndodhja e saktë e njesisë së ndërtesës, presumohet se njësia e ndërtesës ndodhet në zonën e vlerës, që ka çmimin referues më të lartë në territorin e bashkisë.
6. Nëse identifikohet ekzistenca, por nuk arrihet të përcaktohet kategoria e ndërtesës së njesisë së ndërtesës, presumohet se kategoria e njesisë së ndërtesës është ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim.
7. Nëse identifikohet ekzistenca dhe përcaktohet kategoria e ndërtesës së njesisë së ndërtesës që përdoret/shfrytëzohet për banim, por nuk arrihet të përcaktohet kategoria e saj e vlerës, atëherë presumohet se njësia e ndërtesës i përket kategorisë së vlerës të përcaktuar në shkronjën “d”, të pikës 1, të nenit 3, të këtij vendimi.
8. Nëse nga informacioni i mbledhur, mund të identifikohet kategoria potenciale e vlerës së njesisë së ndërtesës, si bodrum ose garazh, por nuk arrihet të identifikohet nëse ajo përdoret/shfrytëzohet për banim ose veprimtari ekonomike, atëherë presumohet se njësia e ndërtesës i përket kategorisë së vlerës korrespondente, në kategorinë ndërtesë që përdoret/shfrytëzohet për banim.
9. Nëse identifikohet ekzistenca dhe përcaktohet kategoria e ndërtesës së njesisë së ndërtesës që përdoret/shfrytëzohet për veprimtari ekonomike, por nuk arrihet të përcaktohet kategoria e saj e vlerës, atëherë presumohet se njësia e ndërtesës i përket kategorisë së vlerës të përcaktuar në pikën 7, të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
10. Nëse identifikohet ekzistenca e banesës, por nuk arrihet të përcaktohet nëse është privatizuar ose jo, presumohet se banesa nuk është privatizuar, në zbatim të legjislacionit për privatizimin e banesave shtetërore.

KREU III

DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 17

Pagesa e taksës mbi ndërtesën

1. Taksa vjetore mbi ndërtesën paguhet me dy këste të barabarta, kësti i parë deri më 31 maj të vitit tatimor dhe kësti i dytë deri më 30 shtator të vitit tatimor, në rastet kur i njoftohet taksapaguesit përmes njoftimit të vlerësimit të taksës mbi ndërtesën.
2. Në rast se taksa vjetore mbi ndërtesën i njoftohet taksapaguesit përmes faturës së lëshuar nga agjenti i caktuar për mbledhjen e saj, ajo paguhet në këste të barabarta mujore, brenda një periudhe 12-mujore. Pagesa e çdo kësti duhet të bëhet deri në datën e fundit për shlyerjen e

detyrimeve mujore ndaj agjentit.

3. Taksapaguesi, i cili nuk paguan taksën mbi ndërtesën në përputhje me pikat 1 dhe 2, të këtij neni, i vendoset gjobë dhe i aplikohet kamatëvonesë sipas parashikimeve në ligjin për procedurat tatimore.

Neni 18

Kërkesa për korrigjim

1. Taksapaguesi mund të kërkojë korrigjimin e vlerës së taksueshme dhe/ose taksës mbi ndërtesën nëse:
 - a. Vlera e taksueshme e njësisë së tij të ndërtesës dhe/ose taksa mbi ndërtesën, është/janë të pasaktë/a;
 - b. Vlera e taksueshme dhe taksa mbi ndërtesën janë llogaritur mbi bazën e faktorëve të prezumuar të parashikuar në nenin 16, të kësaj metodologjie;
 - c. Ai nuk është personi përgjegjës për pagesën e taksës, ose njësia e ndërtesës nuk duhet ti nënshtrohej taksimit, sipas legjislacionit në fuqi. .
2. Kërkesa për korrigjim paraqitet së bashku me dokumentacionin mbështetës përmes të cilit taksapaguesi dëshiron të vërtetojë pretendimet e tij, në strukturën e taksave vendore në bashkinë që ka nxjerrë njoftimin për vlerësimin e taksës mbi ndërtesën, jo më vonë se data 31 dhjetor e atij viti tatimor.
3. Në rastet kur taksa e ndërtesës i njoftohet taksapaguesit përmes faturës së agjentit të caktuar për mbledhjen e saj, kërkesa për korrigjim paraqitet së bashku me dokumentacionin mbështetës, jo më vonë se data 31 dhjetor e atij viti tatimor, në strukturën e taksave vendore në bashki ose në zyrat e agjentit të mbledhjes së taksës, për rastet kur në këto zyra, shërbimi i korrigjimit ofrohet nga bashkia me punonjësit e saj.
4. Bashkia ka detyrimin të shqyrtojë pretendimet dhe të verifikojë dokumentacionin e paraqitur. Kjo përgjegjësi mund të ushtrohet edhe përmes evidentimit në terren në raste të caktuara, nëse ky i fundit vlerësohet të jetë i nevojshëm.
5. Struktura e taksave vendore në bashki shqyrton kërkesën e paraqitur dhe i njofton vendimin (i kthen përgjigje) taksapaguesit, brenda 30 (tridhjetë) ditëve kalendarike nga dita e marrjes së kërkesës për korrigjim.
6. Modeli tip i kërkesës për korrigjim, miratohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksës së Pasurisë, pas konsultimit me bashkitë.

Neni 19

Ankimi administrativ dhe ankimi gjyqësor

1. Taksapaguesi i cili nuk bie dakord me vendimin e marrë nga struktura e taksave vendore në

bashki, mund të paraqesë ankim, bazuar në nenin 7 të ligjit për sistemin e taksave vendore, tek struktura vendore e apelimit tatimor në bashki.

2. Struktura e taksave vendore në bashki shqyrton ankimin dhe merr vendim brenda afatit ligjor të parashikuar në legjislacionin në fuqi.
